



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.30/2025**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Arsim Hamzaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 15.01.2025, mori këtë:

### **V E N D I M**

I. Pranohet pjesërisht e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.30/2025 e datës 14.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.

II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### **A r s y e t i m**

Me datë 14.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se në qytetin e Pejës me datë 13.01.2024 në ora 18:00 në tubimin politik të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kryetari i kësaj partie Albin Kurti dhe kryeministri aktual gjatë fjalimit të tij ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, i cili shprehimisht thotë *“përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Më tutje parashtruesi i ankesës si provë të bashkangjitur është CD-ja me 3 videot që dëshmon shkeljen e pretenduar ku shihet qartë gjuha nxitëse, provokuese, denigruese, fyese e nënçmuese, terme pezhorative, përbuzje dialektike, provokime direkte ndaj kundërshtarëve politik, me theks të veçantë Lidhjes Demokratike të Kosovës e të ngjashme.

Parashtruesi i ankesës ka prezantuar në ankesë tekstin origjinal nga Video 1: *“Nuk ka sesi të mos çuditemi kur dëgjojmë nga udhëheqja e LDK-së se Policia e Kosovës, Kryeministri i Republikës, institucionet e shtetit tonë na qenkan si Serbia e Millosheviqit (krahasim i tmerrshëm, fyerje e shpifje klasike, vrer e mllef i papërmbajtshëm, e pavërtetë e madhe dhe tentim nxitje për rënie në grackën e tij provokuese).*

Por këtu (mendon për Komunën e Pejës) *“siç e dini edhe ju vet LËDËKYHI (term pezhorativ, dhe PËDËKYHI janë në koalicion”*

Parashtruesi i ankesës i citon thëniet në vazhdim: *Prandaj, kur na rastis të dëgjojmë ndonjë udhëheqës të LËDËKYHIT që thotë se po i pëlqen populli, populli ka simpati për ta, kjo mu (flet për veten Kurti) mi përngjan asaj mizës (krahasim fyese, bullizues, nxitës e provokuese) që thoshte kudo që po shkoj po më presin me duartrokitje (ironizon me gjestikulacion dhe shprehje të çuditshme dhe të pakontrolluara të fytyrës)”. Tutje parashtruesi i ankesës thekson se pra, kur ata thojn që populli po i pëlqen ata është si ajo miza që lëvdohej që njerëzit po e presin me duartrokitje e ju e dini shumë mirë që me ato duar që duartrokasin çfarë janë duke provuar t’i bëjnë asaj mize “(aludon në një krahasim të rëndë që tejkalon metaforën e kthehet në gjuhë provokuese të urrejtjes ndaj tjetrit-në këtë rast ndaj udhëheqësit të LDK-së).*

Më tutje në ankesë parashtruesi i ankesës thekson tekstin origjinal nga Video 2, *“e keqja është strukturë e dobësuar (aludon në kundërshtarët e tij politik) dhe gjithnjë më e dobët, Më 9 shkurt sivjet me 500 mijë zemra (këtu përfshin dhe përdor popullin si mjet për të nxitur, provokuar dhe paraçitur urrejtje) kësaj të keqe strukturë ia japim goditjen vdekjeprurëse.....(gjuhë nxitëse dhe e urrejtjes, provokim, madje edhe kërcënim serioz).*

Më tej në ankesë ka theksuar edhe tekstin origjinal nga Video 3, në faqen e rrjetit social, Albini për Kryeministër, me titullin e videos *“T’U E PJEKE OPOZITEN” me tekstin me thurrije #albinkurti #cepmecep #kurti3 është kësisoj: dëgjohe të qeshura fillimisht...pastaj thuhet-qashtu e pjek edhe opozitën, ndërkohë dëgjohe duke qeshur vetë kryeministri Kurti dhe stafi i një biznesi në qytetin e Pejës (pra i njëjti e aprovon këtë gjuhë të urrejtje, denigruese, fyese e përçuese ndaj opozitës në këtë rast), pastaj thuhet-tamon katër, veç katër parti lej qaty, katër a pesë-pesë edhe ka një çerek qitja qaty.*

Sipas parashtruesit të ankesës në rastin konkret dhe në secilin rast, video të bashkangjitur në CD ku mund ta dëgjoj Paneli edhe me audio dhe video, shihet qartë shkelja brutale, e rëndë dhe e pakontestueshme e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 34 paragrafi 1.11.

Andaj, duke u bazuar në gjithë këto prova kërkojmë nga ana e juaj si organ kompetent dhe i autorizuar që të shqiptoni masën adekuate sanksionuese ndaj subjektit politik LVV, për shkeljen që kandidati i tyre për kryeministër ka bërë gjatë vizitës në Pejë, qoftë në tubim kur ka mbajtur fjalimin e tij, qoftë në biznesin që ka vizituar.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur si provë tri video.

Më datë 14.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 15.01.2025 në ora 10:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 15.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe atë për faktin se përshkrimi në fakt kinse i fjalëve të Albin Kurtit në ankesë nuk qëndrojnë dhe për më shumë, këto fjalë të ri-thëna nga kryeministri Albin Kurti janë veç një pasqyrë e deklaratës së Gazmend Muhaxhirit të cilin mund ta dëgjoni në provën e bashkangjitur, si mund të quhet transmetimi dhe kundërshtimi i fjalëve të dikujt tjetër si shkelje e Ligjit dhe Rregulloreve të Zgjedhjeve, pra ne nuk mund të përmbahemi nga diçka që në vetvete nuk përbën shkelje dhe përkundrazi shkelja gjendet diametralisht në anën tjetër, pra te anëtarët subjekti ankues. Më tutje parashtuesi i përgjigjes në ankesë ka paraqitur pretendimet lidhur me video 1, nëse dëgjohet me vëmendje deklaratat e kryeministrit Albin Kurti sa i përket termave të përdorura si LËDËKYHI dhe PËDËKYHI e që subjekti ankues pretendon se janë përdorur, del se të njëjtat nuk kanë bazë ligjore, pasi që asnjëherë kryeministri nuk është deklaruar se ndonjë dialekt i gjuhës shqipe është më superior apo ndonjë dialekt nuk është i duhuri. Andaj, për Lidhjen Demokratike të Kosovës disa dialekte qenkan përbuzje ashtu siç i ka quajtur në ankesë, për kryeministrin Kurti secila nga dialektet që përdor ka rëndësinë e njëjtë, si dhe ka cekur nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Liria e Shprehjes. Duke theksuar se satira e përdorur në këtë rast dhe krahasimi figurativ me mizën nga kryeministri Albin Kurti është në domenin e Lirisë së Shprehjes, këtë e vërtetojnë edhe disa vendime nga praktika e GJEDNJ-së, (shih: Loser v. Austria) 2011, rast ky që specifikisht ka vendosur theksin se satira dhe krahasimet figurative veçanërisht kur janë të drejtuara në politikë lejohen dhe nuk sanksionohen. Tutje në përgjigje në ankesë lidhur me pretendimet për videon 2, parashtuesi i përgjigjes në ankesë e cekë nenin 44 par.1 nën.par.1.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, NR-08/-228, duke elaboruar dispozitat ligjore e njëjta ka për qëllim të fitojë sa më shumë vota, normalisht se kjo nuk bëhet duke lavdëruar kundërshtarët politik, mirëpo duke ua shpërfaqur gabimet e tyre në të kaluarën gjatë qeverisjes. Sa i përket emërtimit “goditje vdekjeprurëse” fjala është për “vdekjen politike” e cila e ka kuptimin e mundjes zgjedhore politike më 09.02.2025. Tutje ka cekur se arsyetimet e njëjta vlejné edhe për videon nr.3 pa dashur të jemi përsëritës, por sipas legjislacionit në fuqi kryeministrit i lejohet të i vizitojë bizneset private. Nga rrethanat e rastit duke analizuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, që kjo ankesë të hedhet poshtë si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, konstatoi se:

### **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

Paneli, pas shikimit të tri videove të ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjete sociale prej nga rrjedh se kryetari i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), - kandidati për kryeministër Albin Kurti me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe promovimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e

Kosovës (LDK) në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të tijë në Pejë i drejtohet me fjalët *“Prandaj, kur na rastis të dëgjojmë ndonjë udhëheqës të LËDËKYHIT që thotë se po i pëlqen populli, populli ka simpati për ta, kjo mi përngjan asaj mizës që thoshte kudo që po shkoj po më presin me duartrokite (ironizon me gjestikulacion dhe shprehje të çuditshme dhe të pakontrolluara të fytyrës)”*, si dhe shprehjet, *“kur ata thonë që populli po i pëlqen ata është si ajo miza që lëvdohej që njerëzit po e presin me duartrokite e ju e dini shumë mirë që me ato duar që duartrokasin çfarë janë duke provuar t’i bëjnë asaj mize.*

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse deklaratat e cekura si më sipër lartë janë në kundërshtime me dispozitat ligjore në fuqi.

Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj subjektit politik LDK është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e mundshme të ligjit si në videot nr. 2 *“e keqja është strukturë e dobësuar dhe gjithnjë më e dobët, Më 9 shkurt sivjet me 500 mijë zemra kësaj të keqe strukturë ia japim goditjen vdekjeprurëse dhe nga Video nr. 3, “T’U E PJEKE OPOZITEN” me tekstin me thurrje #albinkurti # cepmecep # kurti3 “ të njëjta Paneli i refuzoi si te pabazuara.*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet disa vide incizimeve e për Panelin nuk mund të merret se i njëjti ka shkelur nenin 34, pika 1.11 të LZP-në gjegjësisht se ka bërë thirrjet për nxitje të urrejtjes.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e sipërcituar Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë edhe pse nga ofrimi i provës apo dëshmisë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkeljet për të cilat pretendon, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë e pabazuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Neni 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “Vendosja për ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron pjesërisht të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr. 30/2025 më datë 15.01.2025

**Kryesues i Panelit**  
Arsim Hamzaj



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.